


INDEKSI I ÇMIMEVE TË KONSUMIT TETOR 2007



Indeksi i Çmimeve të Konsumit në muajin Tetor 2007, arriti 114.0 përqind kundrejt muajit Dhjetor 2001 (Dhjetor 01=100), duke shënuar një ulje prej 0.1 përqind krahasuar me muajin e kaluar.

Ndryshimi vjetor në muajin Tetor është 4.2 përqind. Një vit më parë ky ndryshim ishte 2.2 përqind.

Indeksi i grupit “Ushqime dhe pije jo alkolike” shënoi një ulje prej 0.3 përqind. Brenda këtij grupi ulja më e madhe prej 4.0 përqind vërehet në nëngrupin “zarzavate përfshirë patatet”. Këtu mund të përmendim uljet e çmimit të spinaqit me 37.2 përqind, lule-lakrës me 31.5 përqind, karrotave me 17.1 përqind, domateve me 11.2 përqind, kastravecave me 10.8 përqind, etj. Indeksi i nëngrupit “fruta” shënoi një ulje prej 3.1 përqind, ku mund të përmendim uljet e çmimit të kivit me 15.9 përqind, portokalleve me 9.4 përqind, mandarinave me 8.5 përqind, mollëve me 3.4 përqind, etj. Gjatë muajit Tetor çmimet janë rritur pothuajse në të gjitha nëngrupet e tjera të këtij grupi, ku mund

të përmendim rritjet në nëngrupet, “vajra dhe yndyrna” me 2.0 përqind, “qumësht djath e vezë” me 1.1 përqind, “bukë e drithra” me 0.7 përqind dhe “peshk” me 0.5 përqind, “mish” me 0.2 përqind, etj.

Indeksi i grupit “Veshje dhe këpucë” shënoi një rritje prej 0.4 përqind. Brenda këtij grupi nëngrupi “veshje” shënoi një rritje prej 0.4 përqind, ndërsa çmimet e nëngrupit “këpucë” nuk kanë ndryshuar gjatë muajit Tetor.

Indeksi i grupit “Pije alkolike dhe duhan” shënoi një ulje prej 0.1 përqind, ku mund të përmendim uljen e çmimit të cigareve me 0.3 përqind.

Indeksi i grupit “Qera, ujë lëndë djegëse dhe energji” shënoi një rritje prej 0.1 përqind, ku mund të përmendim rritjen e çmimit të gazit të lëngshëm me 2.2 përqind.

Ndërsa ndryshimet në grupet e tjera variojnë nga - 0.1 përqind në + 0.3 përqind.